

# Raporti Ekonomik për Rajonin e Europës dhe Azisë Qendrore


Pranverë 2022

## Përmbledhje

Në shkurt 2022, bota u trondit nga pushtimi i Ukrainës nga Federata Ruse. Lufta po shkakton pasoja katastrofike në jetët e njerëzve, po dëmton rëndë ekonominë e të dy vendeve, si dhe pritet të çojë në humbje të konsiderueshme ekonomike në rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore (EAQ) dhe në pjesën tjetër të botës. Kjo është goditja e dytë e madhe brenda dy viteve që shkakton një tkurrje ekonomike të rajonit. Prodhimi në vitin 2022 parashikohet të tkurret me 4.1 për qind – dy herë më e lartë se recesioni i 2020 i shkaktuar nga pandemia COVID-19.

Vendet e rajonit ishin të përgatitura për një ngadalësim të rikuperimit nga COVID-19 të nisur në 2021, si rezultat i tkurrjes së rritjes ekonomike dhe tregtisë, presioneve inflacioniste, shqetësimeve lidhur me qëndrueshmërinë e borxhit dhe rritjes së normave të interesit. Ndër çështjet shqetësuese ishin edhe ndërprerjet e vazhdueshme për shkak të COVID-19 dhe përshkallëzimi i tensioneve gjeopolitike. Lufta ka përkeqësuar më tej perspektivën, ndërsa pasojat ekonomike nga konflikti në Ukrainë po fillojnë të ndihen nëpërmjet disa kanaleve të transmetimit të krizës, përfshirë tregjet e mallrave, tregjet financiare, lidhjet tregtare, migracionin dhe besimin e investitorëve.

Vendet e EAQ-s që janë fqinje me Rusinë dhe Ukrainën, ka të ngjarë të pësojnë dëme të konsiderueshme ekonomike për shkak të lidhjeve të tyre të forta tregtare, financiare dhe migracionit me këto dy vende. Rusia është një ndër eksportuesit kryesorë të energjisë dhe metaleve industriale, dhe së bashku me Ukrainën, përbën mbi 25 për qind të totalit të eksporteve globale të grurit. Evropa është veçanërisht e varur nga energjia ruse, pasi importon rreth 47 për qind të gazit natyror dhe 25 për qind të naftës nga Rusia. Armenia, Gjeorgjia, Kazakistani dhe Turqia importojnë mbi 75 për qind të grurit nga Rusia dhe Ukraina, dhe shumë vende të Lindjes së Mesme dhe Afrikës mbështeten në importet e grurit dhe



mallrave të tjera nga Rusia dhe Ukraina, gjë që mund të çojë në pasiguri në furnizimin me ushqime.

Mungesat në furnizime dhe rritja e çmimeve të energjisë dhe ushqimeve do nxisin rritjen e inflacionit, duke dëmtuar vendet e rajonit, si dhe pjesën tjetër të botës. Për më tepër, megjithëse Rusia dhe Ukraina përbëjnë më pak se 3 për qind të eksporteve globale, lufta dhe sanksionet kanë dëmtuar konektivitetin midis vendeve duke ndërprerë rrugët tregtare dhe duke rritur kostot e transportit dhe sigurimit të mallrave. Kjo situatë po rrit tensionet ekzistuese në zinxhirët globalë të vlerës, duke prekur një gamë të gjerë industrish, si atë të ushqimit, automobilave, ndërtimit, petrokimikateve dhe transportit. Tensionet e shtuara në zinxhirët globale të vlerës, së bashku me çmimet e rritura të mallrave, po rrisin akoma më shumë presionet inflacioniste.

Rusia është destinacion i rëndësishëm i eksporteve të shumë vendeve të Evropës Lindore, Kaukazit të Jugut, Azisë Qendrore dhe Balltikut, duke përbërë mbi 10 për qind të totalit të eksporteve të tyre dhe rreth 25 për qind për Armeninë dhe mbi 40 për qind për Bjellorusinë. Remitancat me origjinë nga Rusia përbëjnë afërsisht 30 për qind të prodhimit të brendshëm bruto të disa vendeve të Azisë Qendrore, si Republika e Kirgiztanit dhe Taxhikistanit. Turistët rusë dhe ukrainas përbëjnë më shumë se 10 për qind të numrit total të turistëve në rreth gjysmën e ekonomive të EAQ-s, përfshirë ato që varen nga turizmi, si Gjeorgjia, Mali i Zi dhe Turqia.

Lufta dhe sanksionet financiare ndaj Ruisë kanë sjellë pasoja të rënda në sistemin financiar të vendit dhe kanë kufizuar aftësinë e vendit për të paguar detyrimet financiare, duke ndikuar në sistemet financiare në rajon dhe më gjerë. Konflikti i vazhdueshëm ka të ngjarë të shkaktojë ulje të mëtejshme të besimit të investitorëve dhe rikthim të flukseve dalëse të investimeve të portofolit dhe nënçmimit të monedhave të vendeve të rajonit. Veçanërisht të rrezikuara janë ato vende që kanë deficite të larta të llogarisë korente ose pjesë të mëdha të borxhit të shprehur në valutë të mbajtur nga jo-rezidentët, ose borxhit afatshkurtër, të cilat mund të përpiqen të zgjasin afatin e borxhit ose të përballen me detyrime shumë më të larta për shërbimin e borxhit.

Lufta po shkakton gjithashtu një valë destabilizuese refugjatësh. Nga Ukraina janë larguar më shumë se 4 milionë njerëz, ku më shumë se gjysma e tyre kanë hyrë në Poloni dhe shumë të tjerë kanë hyrë në Hungari, Moldavi dhe Rumani. Në kushtet që numri i refugjatëve vlerësohet të rritet në muajt e ardhshëm, vendet pritëse do të duhet të përballen me sfidën e akomodimit të tyre. Për të rritur kapacitetet akomoduese dhe për të siguruar ofrimin e shërbimeve bazë do të ketë nevojë për mobilizim me shpejtësi të burimeve financiare shtesë dhe rritje të ndihmës humanitare. Varfëria në rajon pritet të rritet për shkak të recesionit dhe inflacionit të çmimeve të ushqimeve si rezultat i luftës. Aktualisht, numri i të shpërngulurve brenda Ukrainës vlerësohet të jetë 6.5 milionë njerëz dhe rreth një e treta e popullsisë ka nevojë për ndihmë urgjente humanitare.

Ndikimi i luftës në perspektivën ekonomike të rajonit varet nga mënyra se si do të evoluojë konflikti në vazhdim. Nëse konflikti do të gjejë zgjidhje brenda muajve në vijim, humbjet mund të frenohen dhe mund të fillojë rikuperimi. Tejzgjatja e konfliktit mund të çojë në rritje të kostove në njerëz dhe ekonomi,

pasigurisë së politikave, fragmentizim të integritit rajonal dhe ndërprerje të lidhjeve të rëndësishme tregtare dhe investimeve.

Në këto kohë të vështira, politikëbërësit duhet të forcojnë amortizuesit dhe institucionet e politikave makroekonomike për të konsoliduar stabilitetin ekonomik; të promovojnë një rimëkëmbje gjithëpërfshirëse dhe më të barabartë duke forcuar sistemet e mbrojtjes sociale për të mbrojtur shtresat më të cënueshme, përfshirë refugjatët; dhe të ruajnë fokusin në përmirësimin e efikasitetit të energjisë dhe tranzicionit drejt ekonomisë së gjelbër për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme. Adresimi i pasojave negative të ndryshimeve klimatike është një nga çështjet më urgjente të kohës sonë. Lufta dhe rritja e menjëhershme dhe e konsiderueshme e çmimeve të energjisë tradicionale evidentojnë akoma më shumë nevojën për tërheqjen e investimeve në burime të rinovueshme dhe rëndësinë e ndryshimit të sistemeve të energjisë drejt një energjie më të lirë, më të pastër dhe më të qëndrueshme. Përmirësimi i efikasitetit të energjisë, reduktimi i konsumit të panevojshëm të energjisë dhe përdorimi i inovacioneve teknologjike do t'u mundësonte ekonomive të rajonit zbutjen e ndikimit negativ të luftës në rritjen ekonomike.